



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 05 janar 2021
Nr. ref.:RK 1689/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. K108/19

Parashtrues

Gafurr Haziri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.258/2018, të 6 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gafurr Haziri, nga fshati Vërban, Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Pml. nr.258/2018, të 6 nëntorit 2018, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 janar 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani, (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 30 janar 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi e Gjykatën Supreme për regjistrim të kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
8. Më 10 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

9. Më 30 qershor 2015, Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ngriti aktakuzë (PP.II.Nr.1021/2015) kundër parashtruesit të kërkesës nën dyshimin e bazuar se ka kryer veprën penale "rrezikim i trafikut publik" nga neni 378, paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).

10. Më 12 mars 2018, Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit P.nr.353/2015, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale *"rrezikim i trafikut publik"* nga neni 378, paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK dhe e dënoi atë me gjobë në vlerë prej 200 (dyqind) euro.
11. Gjykata Themelore, në Aktgjykimin e saj theksoi se vendimin e saj e bazoi ndër të tjera edhe në dy ekspertizat e komunikacionit (njëra ekspertizë private dhe tjetra me kërkesë të Gjykatës Themelore) të zhvilluara lidhur me këtë çështje si dhe në bazë të super-ekspertizës. Në bazë të ekspertizave të lartpërmendura rezultoi se deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve primare të të dëmtuarit A.I. dhe lëshimeve sekondare të parashtruesit të kërkesës. Në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore gjithashtu vërehet se lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike janë marrë parasysh edhe deponimet e shumë dëshmitarëve të rastit.
12. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin.
13. Më 14 maj 2018, Prokuroria e Apelit përmes shkresës PPA/II NR. 498/2018 i propozoi Gjykatës së Apelit refuzimin e ankesës, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
14. Më 12 korrik 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1.nr. 491/2018 refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
15. Gjykata e Apelit vlerësoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se *"aktgjykimi është i qartë konkret dhe i kuptueshëm, në arsyetimin e tij janë dhënë, arsye të duhura të mjaftueshme, mbi të gjitha faktet vendimtare si dhe janë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit"*.
16. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit PA1.nr. 491/2018 të Gjykatës së Apelit të 12 korrikut 2018 dhe Aktgjykimit P.nr.353/2015 të Gjykatës Themelore, të 12 marsit 2018, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu duke mos e kontestuar faktin se aksidenti ka ndodhur si pasojë e lëshimeve sekondare të tij, ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë *"nuk e ka kthyer aktakuzën për zgjerim edhe ndaj personit tjetër por vetëm ai është shpallur fajtor"*.
17. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit të Kosovës, përmes shkresës KMPL II.nr.180/2018 kishte propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

18. Më 30 prill 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. nr. 258/2018, refuzoi si të pabazuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
19. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj arsyetoi se *“çështja e ndryshimit të aktakuzës është e drejtë diskrecionale e Prokurorit të Shtetit e për këtë Gjykata nuk mund të urdhëroj Prokurorin [...] Konkludimet e të dy Gjykatave lidhur me përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale është rezultat i vlerësimit të drejtë të provave të administruara, për çfarë dy gjykatat kanë dhënë arsye të qarta ligjore të paraqitura në 5-6 respektivisht 3-4 të aktgjykimit të shkallës së dytë, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë meqë drejt është aplikuar ligji penal”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
21. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij pretendon se Gjykata Themelore e ka shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor, edhe pse sipas tij me prova materiale është vërtetuar se i njëjti nuk është fajtor për këtë vepër penale.
22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *“vendimi i gjyqtarës ka qenë tendencioz, në fillim edhe unë si i akuzuar kam shfrytëzuar të drejtën për caktimin e ekspertit komunikacionit conform nenit 141 të KPRK-së, mirëpo gjyqtari qysh në këtë procedurë shifet se ka qëllim vetëm dënimin tim me Aktgjykim dënues, ngase ekspertizën me aktvendime kundërshton edhe pse prokuroris i kemi dorëzuar me koh kopje mirëpo na e mohoi të drejtën, mirpo gjatë procedurës nxirret një ekspertizë me propozim Gjykatës dhe prokuroris prap se prap edhe kjo ekspertizë vërteton ekspertizën e parë, po ashtu gjatë stadi procedural propozohet superekspertizë e komunikacionit të cilën e përpilon Fakulteti Teknik UP i Prishtinës, nga tre ekspertë ku mua më lën vetëm lëshim sekondar, mirëpo as që mirret për bazë nga Prokuroria e më pastaj nga Gjykata”*.
23. Lidhur me vendimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata është dashur të gjykoj në bazë të provave dhe të marr drejtësinë unë si qytetar së paku nga gjykata e jo të më mohojë drejtën që të jem i pafajshëm ngase kam lëshim sekondar në asnjë mënyrë nuk jam kryes i veprës penale, po ashtu prokuroria gjatë fazës hetimore nuk zhvillon fare hetime pa asnjë ekspertizë pa më marrë në pyetje vetëm më akuzon [...]”*.
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që ta aprovojë kërkesën e tij dhe të anulojë vendimin e kontestuar duke e kthyer çështjen në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

28. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, respektivisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës,

Pml. nr. 258/2018 të 6 nëntorit 2018, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i ka sqaruar pretendimet e tij për ato të drejta dhe liri që ai pretendon se i janë shkelur përmes vendimeve gjyqësore, në pajtim me kushtet që kërkohen nga neni 48 i Ligjit si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

29. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

30. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës përmes Aktgjykimit P.nr.353/2015 të Gjykatës Themelore ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale “rrezikim i trafikut publik” nga neni 378, paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK, dhe ishte dënuar me gjobë në vlerë prej 200 euro. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke e vërtetuar Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore. Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, kundër dy vendimeve të instancave më të ulëta.
31. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ
32. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pothuajse në tërësinë e kërkesës së tij para Gjykatës përsërit të njëjtat pretendime, të cilat i kishte paraqitur edhe në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Në lidhje me pretendimet e sipër cekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se ai është shpallur fajtor pa kryerjen e hetimeve nga ana e prokurorisë, dhe pa u përpiluar ekspertizat e komunikacionit. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se ai ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale, edhe pse sipas parashtruesit të kërkesës, bazuar në prova materiale, është vërtetuar se i njëjti nuk është fajtor për këtë vepër penale. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar, në thelb pretendon se ai është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale, në kundërshtim me të gjeturat e ekspertizës së komunikacionit dhe superekspertizës, duke pretenduar se nga konstatimet e këtyre ekspertizave del se aksidenti i komunikacionit ndër të tjera ka ndodhur për shkak të lëshimeve sekondare të parashtruesit, pra nuk është konstatuar se ai ka qenë përgjegjësi kryesorë për shkaktimin e aksidentit.
33. Prandaj, Gjykata në vijim, pretendimet e parashtruesit të kërkesës do t'i elaborojë në dritën e garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën,

Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

34. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 1 i Kushtetutës përcakton:

*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
[...]*

35. Neni 6 paragrafët 1 dhe 2 i KEDNJ-së parasheh që:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. [...].”

36. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi pretendimet për mos vërtetimin e drejtë të provave dhe fakteve, të bërë nga Gjykata Supreme dhe ato të instancave më të ulëta.

37. Megjithatë, Gjykata ka parasysh arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin PML.nr.258/2018 i cili në lidhje me provat kishte theksuar si në vijim: *”vlerëson si të pabazuar pretendimin në fjalë sepse nga shkresat e çështjes rezulton si i pakontestueshëm fakti se në aksidentin e ndodhur Gafurr Haziri, ka qenë kontribuues i cili sipas ekspertizave të bëra nuk e ka përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave të qarkullimit, ndërsa shkaktari kryesor i aksidentit ishte ngasësi i automjetit VW/Passat respektivisht këtu i dëmtuari A.B [...] Pretendimin se aktgjykimi i shkallës së parë bazohet vetëm në kallëzimin penal dhe raport policor por jo edhe në ekspertizat e komunikacionit, kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar për faktin se aktgjykimi i shkallës së parë, të cilin e ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë, nuk mbështetet vetëm në kallëzimin penal dhe raportin e policisë, përkundrazi ajo mbështetet edhe në provat tjera formale dhe materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, në radhë të parë në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit [...].”*

38. Gjithashtu, Gjykata ka parasysh arsyetimin e Gjykatës Themelore P.nr.353/2015, i cili ishte konfirmuar edhe nga shkalla e dytë dhe ku, ndër të tjera, theksohet se për këtë çështje janë zhvilluar 8 (tetë) seanca gjyqësore, janë administruar të gjitha provat dhe ndër të tjera edhe dy ekspertiza, njëra ekpertzë private e cila gjendet në prokurori, ekspertiza tjetër e komunikacionit me kërkesë të Gjykatës Themelore dhe super-ekspertiza, si dhe janë vlerësuar deponimet e dëshmitarëve të rastit.
39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe dy gjykatat e instancës më të ulët, kanë dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme për gjetjet dhe konstatimet e tyre. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj i ishte përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
40. Në dritën e kësaj, ne lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetues, bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe gjithëpërfshirës, dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
41. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih, rasti *Garía Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
42. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë.
43. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendimi për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi* Aktvendimi për papranueshmëri i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe se

fundmi rastin KI125/19 parashtrues: Ismajl Bajgora, Aktvendimi për papranueshmëri i 11 marsit 2020, paragrafi 63).

44. Në rastin para nesh, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës arsyetoi se Gjykata e Apelit, me të drejtë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, pasi nga të gjitha provat del se deri tek aksidenti i komunikacionit në mes tjerash ka ardhur për shkak të lëshimeve sekondare të parashtruesit të kërkesës.
45. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
46. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës, sepse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, duke marrë parasysh që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe që parashtruesi i kërkesës nuk e dëshmon mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje kushtetuese.
47. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me Rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, 10 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi

